TaxNews
SPECIAL

Janar 2018
January 2018



Deloitte.

Parlamenti i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjet e Paketës Fiskale 2018, të cilat janë publikuar në *Fletoren Zyrtare Nr. 222, datë 19.12.2017.*

Më poshtë kemi përgatitur një përmbledhje me ndryshimet kryesore që sjell çdo ligj i Paketës Fiskale.

I. Shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"

Përjashtimi nga tatimi mbi fitimin i strukturave akomoduese 'Hotele me 4 dhe 5 yje, me status special'

Duke filluar nga data 01.01.2018, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin strukturat akomoduese 'Hotele me 4 e 5 yje, me status special' sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht (brand name), për një periudhë prej 10 vitesh duke filluar nga nisja e aktivitetit, por jo më vonë se 3 vite nga marrja e statusit special.
Këtë përjashtim e përfitojnë ato 'Hotele me 4 e 5 yje, me status special' që këtë status do ta marrin deri në dhjetor 2024.

Ulja e normës së tatimit mbi fitimit për shoqëritë që prodhojnë/zhvillojnë software

Shoqëritë që prodhojnë/zhvillojnë software do të jenë subjekt i tatimit mbi fitimin në shkallën e reduktuar prej 5% *(nga 15% që është norma standarde e zbatueshme për to deri me 31.12.2017)*.

The Parliament of the Republic of Albania has approved the laws of the 2018 Fiscal Package, published in the *Official Gazette No. 222, dated 19.12.2017.*

Here below we have presented a summary with the main amendments brought by each law of the Fiscal Package.

I. Additions and amendments to the Law no. 8438, dated 28.12.1998 "On income tax"

Exemption from corporate income tax of accomodation facilities 'Four and five stars hotels, with special status'

Starting from 01.01.2018, accomodation facilities "Four and five stars hotels, with special status" holders of an internationally recognized and registered trademark (brand name), based on the definitions of the legislation on tourism, are exempted from corporate income tax for a period of 10 years starting from the commencement of activity, but no later than 3 years from the moment of obtaining the special status.
This exemption is granted for the "Four and five stars hotels, with special status" which will obtain this status until December 2024.

Reduction of corporate income tax rate for software production/development companies

Companies that produce/develop software are subject to a corporate income tax rate of 5% *(instead of the 15% standard rate applicable until 31.12.2017)*.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave pritet të miratohen rregullat dhe procedurat për zbatimin e kësaj shkalle tatimore të reduktuar për këto shoqëri.

Tatimi i të ardhurave të organizatorëve të lojërave të fatit

Një shtesë në dispozitat kalimtare të Ligjit ka parashikuar se të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit do të tatohen me tarifën tatimore mbi 'të ardhurat bruto', sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës. Mbetemi në pritje të akteve nënligjore për të sqaruar më tej mënyrën e zbatimit të këtij parashikimi.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme hyjnë në fuqi më 01.01.2018.

II. Shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 92/2014 "Për TVSH-në"

Reduktimi i normës së TVSH për të gjitha shërbimet e ofruara nga strukturat akomoduese 'Hotele/resorte me 5 yje, status special'

Duke filluar nga data 01.01.2018, për të gjitha furnizimet e shërbimeve të kryera brenda strukturave akomoduese 'Hotele/resorte me 5 yje, me status special' që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht (brand name) do të zbatohet një normë e reduktuar e TVSH-së prej 6%. *(Deri më 31.12.2017, për të gjitha furnizimet e shërbimeve brenda strukturave akomoduese ngarkohet TVSH në normën standarde 20%, me përjashtim të furnizimit të akomodimit në vetvete mbi të cilin, prej datës 05.06.2017, ngarkohet TVSH në normën 6%)*.

Rules and procedures for the application of this reduced tax rate applicable to these companies are expected to be approved through a Decision of the Council of Ministers.

Taxation on income of gambling organizers

An addition in the transitory provisions of the law provides that income of the gambling organizers are taxed with the tax rate on "gross revenues", according to the meaning and provision in the respective industry laws.
We are in attendance of the respective by-laws to further clarify the way this provision shall apply.

All the above amendments enter into force from 01.01.2018.

II. Additions and amendments to the Law no. 92/2014 "On value added tax"

Reduction of the VAT rate for all services provided from accomodation facilities "Five stars hotels/resorts, with special status"

Starting from 01.01.2018 all supplies of services performed within the accommodation facilities ''Five stars hotels/resorts, with special status'' holders of an internationally recognized and registered trademark (brand name) are subject to a reduced VAT rate of 6%. *(Until 31.12.2017, for all supplies of services provided within the accommodation facilities, VAT is charged at the standard rate of 20%, except for the supply of accommodation service itself, on which the reduced VAT rate of 6% is chargeable since 05.06.2017)*.

Këshilli i Ministrave do të përcaktojë, kushtet, kriteret dhe procedurat e aplikimit të kësaj norme të reduktuar.

Periudha tatimore për qëllime të TVSH

Për kategori të caktuara tatimpaguesish e me Vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, mundet që të përcaktohen periudha tatimore për qëllime të TVSH-së më të gjata se një muaj kalendarik, por jo më të gjata se një vit kalendarik.

Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH

Ligji zgjeron kompetencën e Këshillit të Ministrave që, përveçse ka të drejtë të miratojë kurifin minimal të regjstrimit për TVSH, do të ketë gjithashtu të drejtën të parashikojë edhe rastet e përjashtimit apo kufirin minimal të regjistrimit për kategori të veçanta personash të tatueshëm. (Për kufirin e regjistrimit për TVSH dhe përjashtimet apo kufizimet përkatëse lutemi referojuni "Tax News November 2017".)

Të gjitha ndryshimet e mësipërme hyjnë në fuqi më 01.01.2018.

III. Shtesa e ndryshime në Ligjin Nr. 9632, datë 30.01.2006 "Për sistemin e taksave vendore"

Taksa e ndërtesës

Baza tatimore dhe shkalla e taksës së ndërtesës

Ligji parashikon ndryshimin e bazës së tatueshme dhe të shkallës së taksës mbi pasuritë e paluajtshme vetëm për kategoritë ndërtesa:

The Council of Ministers shall determine the conditions, criteria and procedures for the application of the reduced rate.

Tax period for VAT purposes

For specific categories of taxpayers, a special Decision of the Council of Ministers may determine tax periods for VAT purposes longer than one month, but not longer that one calendar year.

Minimum threshold for VAT registration

The law extends the competence of the Council of Ministers so that, besides being entitled to approve the minimum VAT registration threshold, it will also be entitled to provide for cases of exemption from VAT or for the minimum threshold for VAT registration for special categories of taxable persons. (For the VAT registration threshold and the respective exemptions or limitations, please refer to our "Tax News November 2017".)

All the above amendments enter into force from 01.01.2018.

III. Additions and amendments to Law no. 9632, dated 30.01.2006 "On local taxes"

Tax of buildings

The tax base and the tax rate of buildings

The law has amended the taxable base and the tax rate on immovable properties, only for the category buildings:

- Baza e tatueshme për zbatimin e taksës së ndërtesës do të jetë vlera e tregut të saj *(më parë ishte sipërfaqja, e korrektuar me vend-ndodhjen, vjetërsinë dhe qëllimin e përdorimit)*. Metodologjia e për-llogaritjes së vlerës së tregut të ndërtesës do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Shkalla e taksës së ndërtesës (e zbatueshme mbi bazën e tat-ueshme përcaktuar si më lart) do të jetë:

  a. 0.05% për ndërtesën që për-doret/shfrytëzohet për banim;

  b. 0.2% për ndërtesën që për-doret/shfrytëzohet për vep-rimtari ekonomike;

  c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipër-faqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Kjo taksë do të llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit e do të paguhet çdo muaj (apo për periud-ha më të gjata, në varësi të kate-gorisë së taksapaguesit). Këshilli i Ministrave mund të autorizojë me vendim të posaçëm agjentë për mbledhjen e kësaj takse.

Krijimi i Kadastrës Fiskale

Me qëllim administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme, do të krijohet regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme ose quajtur ndryshe Kadastra Fiskale.

- The taxable base for the tax of buildings will be its market value *(previously the taxable base was the surface area, corrected by the location, age and purpose of use)*. The methodology for calculating the market value of the buildings will be determined by a Decision of the Council of Ministers.

- The tax rate for buildings (applica-ble on the taxable base determined as above) will be:

  a. 0.05% for the buildings used/ exploited for habitation;

  b. 0.2% for the buildings used/ex-ploited for business purposes;

  c. 30% of the respective tax rate for the entire construction site for which the builder has obtained a construction permit and has failed to complete the construction according to the deadline set in the approving act of the request for the construc-tion permit.

This tax will be calculated as an annual liability of the taxpayer and will be paid on a monthly basis (or on longer periods, depending on the category of the taxpayer). The Council of Ministers may authorize agents for the collection of this tax through a specific decision.

Establishment of the Fiscal Cadas-tre

In order to administer the tax on immovable property, a central register of the real estate database or otherwise named as Fiscal Ca-dastre will be established.

Kadastra Fiskale do të menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, e cila do të jetë një institucion në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kësaj drejtorie do të miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Përjashtime nga taksa e ndërtesës

Kategoritë e mëposhtme i janë shtuar listës së përjashtimeve nga taksa e ndërtesës:

a. ndërtesat e banimit të krye-familjarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;

b. ndërtesat e banimit të krye-familjarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

c. banesat sociale në pronësi të bashkive ose në përdorim të tyre për këtë qëllim në marrëveshje me pronarët përkatës;

d. ndërtesat kulturore nën mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore;

e. strukturat akomoduese "Hotel me 5 yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht (brand name).

The Fiscal Cadastre will be managed by the General Directorate of Property Tax, an institution under the responsibility of the minister in charge for finance. The rules for the organization and functioning of this directorate will be approved by the Council of Ministers.

Exemptions from the tax of buildings

The following categories have been added to the list of exemptions from the tax of buildings:

a. residential buildings of heads of households, who benefit retirement or social pensions, who live in city or villages, when the family consists of only pensioners;

b. residential buildings of heads of households, who are treated with economic aid;

c. social houses owned by or used by municipalities for this purpose in mutual agrement with the respective owners;

d. cultural buildings under the protection for cultural monuments and/or cultural inheritance in accordance with the legislation in force;

e. accommodation facilities "Five stars hotels, with special status" as per the definition provided in the legislation on tourism, holders of an internationally recognized and registered trademark (brand name).

Përjashtime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel me 5 yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht (brand name).

Ankimimi

Pranë çdo Njësie Vendore (Bashki) do të ngrihet struktura vendore e apelimit tatimor. Çdo taksapagues do të ketë të drejtë t'i drejtohet kësaj strukture për të ankimuar vendimet apo veprimet e zyrës vendore të taksave.
Pritet që me vendim të Këshillit Bashkiak të përcaktohen rregullat dhe kriteret për apelimin. Më tej, taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki. *(Më parë vendimet apo veprimet e zyrës vendore të taksave ankimoheshin pranë Kryetarit të Bashkisë)*.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme hyjnë në fuqi më 01.04.2018, përveç dispozitës ku parashikohet përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel me 5 yje, status special", e cila hyn në fuqi më 01.01.2018.

Exemptions from tax of impact on infrastructure

Investments made in relation to construction of accommodation facilities "Five star hotels, with special status" pursuant to the definition provided in the legislation in force on tourism and holders of an internationally recognized and registered trademark (brand name) will be exempt from the tax of impact on infrastructure.

Appeal

In every Local Unit (Municipality) will be established the local tax appeal structure. Every taxpayer has the right to address to this structure the appeal on the decisions or actions of the local tax office.
The rules and criteria for the appeal procedure are expected to be determined through a decision of the Municipal Council. Afterwards, the taxpayer has the right to appeal in court the decision of the tax appeal structure of the Municipality. *(Previously decisions or actions of the local tax office were appealed to the Mayor)*.

All the above amendments enter into force on 01.04.2018, except for the exemption from the tax of impact on infrastructure granted for investments of construction of accommodation facilities "Five stars hotel, with a special status", which enters into force on 01.01.2018.

IV. Ndryshime në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare"

Automjetet luksoze

Që prej 01.01.2016, automjetet luksoze të tipit 'deri në 4+1' me fuqi motorike të barabartë ose më të madhe se 3,000 cm3 ose me çmim të barabartë ose më të lartë sesa 5,000,000 lekë, janë subjekt i dy taksave: taksës së regjistrimit fillestar dhe taksës së përvitshme. Që prej 01.01.2018, automjete luksoze për efekte të zbatimit të këtyre dy taksave do të konsiderohen ato të tipit 'deri ne 6+1'.

V. Ndryshim në Ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat"

Që prej datës 01.01.2018 hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme në nivelin e akcizës:

- Rritet niveli i akcizës për produktin "Duhan dhe nënproduktet e tij", kategoria T200 "Cigare që përmbajnë duhan", me kod nomenklature 24 02 20 dhe përshkrim "Cigare që përmbajnë duhan" nga 5,750 lekë/1000 copë në 5,850 lekë/1000 copë;
- Produkti "Pije energjitike", kategoria D000, me kod nomenklature 22 02 10 00 dhe përshkrim 'Pije energjitike' nuk është më subjekt akcize *(deri me 31.12.2017 niveli i akcizës për këtë produkt ishte 30 lekë/litër)*;
- Për produktin "Rëra bituminoze", kategoria E492, me kod nomenklature 27 14 10 00, niveli i akcizës përcaktohet 2 lekë/kg *(deri me 31.12.2017 ky produkt nuk ishte objekt akcize)*;

IV. Amendments to Law no. 9975, dated 28.07.2008 "On national taxes"

Luxurious vehicles

Starting from 01.01.2016, luxurious vehicles of the type "up to 4+1" with a motor power equal or greater than 3,000 cm3 or with a price equal to or higher than 5,000,000 ALL, are subject to two taxes: initial registration tax and annual tax.
Starting from 01.01.2018, luxurious vehicles for the purposes of these two taxes are considered those of type "up to 6+1".

V. Amendments to Law no. 61/2012 "On excise tax"

Starting from 01.01.2018, the following amendments on excise taxes for certain products enter into force:

- Increase of the amount of excise tax for the product "Tobacco and its by-products", category T200 "Cigarettes which contain tobacco", with the nomenclature code 24 02 20 and description "Cigarettes which contain tobacco" from 5,750 ALL/1000 pieces to 5,850 ALL/1000 pieces;
- The product "Energy drink", category D000, with nomenclature code 22 02 10 00 and description "Energy drink" will be no longer subject to excise tax *(until 31.12.2017 the level of excise tax for this product was 30 ALL/liter)*;
- The product "Bituminous sand", category E492, with nomen-

- Për produktin "Nikotinë lëng për mbushen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosje", në kategorinë T401, me kod nomenklature 38 24 99 56 dhe 38 24 99 57, përcaktohet niveli i akcizës 10 lekë/ml *(deri më 31.12.2017 ky produkt nuk ishte objekt akcize)*.

Importuesit dhe prodhuesit e letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin e nomenklaturës 4813 1000 duhet të marrin autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Pritet që Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të nxjerrë një udhëzim për të përcaktuar kriteret, rregullat, procedurat e marrjes së këtij autorizimit.

VI. Ligji nr. 103/2017, date 30.11.2017 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore"

Që prej datës 01.01.2018 ulet niveli i tarifës doganore për disa mallra, të cilat janë të përcaktuara në Aneksin 1 që i bashkëlidhet Ligjit me kodet respektive të nomenklaturës, të listuara dhe më poshtë:

- Disa mallra me kod nomenklature 3215 "Bojra shkrimi, bojrat shtypi dhe vizatimi dhe bojra te tjera, nëse janë apo jo të koncentruar apo të ngurta";

- Mallrat "Të tjera" me kod nomenklature 5911 90;

clature code 27 14 10 00 will be subject to excise tax at the amount of 2 ALL/kg *(until 31.12.2017 this product was not subject to excise tax)*;

- The product "Nicotine juice for the filling of electronic cigarettes set in codes 85 43 70 90, used for the creation of a smoking process", in the category T401, with nomenclature codes 38 24 99 56 and 38 24 99 57 will be subject to excise tax at the amount of 10 ALL/ml *(until 31.12.2017 this product was not subject to excise tax)*.

Importers and producers of cigarette papers in the form of brochures or tubes included in the nomenclature code 4813 1000 shall obtain authorization from the General Customs Directorate. An instruction of the General Customs Directorate is expected to be published, where the criteria, rules and procedures for obtaining such authorization will be determined.

VI. Law No. 103/2017, dated 30.11.2017 "On the approval of customs tariffs"

Starting from 01.01.2018, the customs tariff level is lowered for certain goods as defined in Annex 1 attached to this Law with the respective Nomeclature Code as listed below:

- Some goods with nomeclature code 3215, "Writing ink, printing and drawing ink, and other inks, concentrated or solid";

- "Other" goods with nomeclature code 5911 90;

- Disa mallra të Kapitullit 84 “Reaktorët nukleare, bolieret, makineri dhe paisje mekanike; pjesët e tyre”;

- Disa mallra të Kreut 90 “Instrumentat dhe aparatet optike, fotografike, kinematografike, matëse, kontrolli, precizioni, mjeksore ose kirurgjikale; pjesët dhe plotësuesit e tyre”.

- Certain goods of Chapter 84 "Nuclear reactors, boilers, machinery and mechanical appliances; their spare parts";

- Certain goods of Chapter 90 “Optical, photographic, cinematographic, measuring, checking, precision, medical or surgical instruments and apparatus; their parts and accessories".

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA
Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.
No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

***

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.
Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 244,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

© 2018 Deloitte Albania sh.p.k